



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORTITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BULQIZE

Nr \_\_\_\_prot

Bulqize më, \_\_\_\_12.2025

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Shërbime projektimi për investimet që do të realizohen nga Bashkia Bulqize me financim nga buxheti i shtetit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71335000-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: : 9 994 154,30** (nente milion e nentëqind e nentëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër pike tridhjetë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a . Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

*Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

#### ***Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”***

*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

## **2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet financiare 2022, 2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres së Fondit Limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet\_“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”

**2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, ”.**

**3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) pika 4, paragrafi 2: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, **duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit. Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Neni 43/ 4 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kanë detyrime të prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

\* Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar neni 82 të LPP-së dhe neni 26, pika 1 të RPP-së, i ndryshuar. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia

Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) citohet:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

*Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj marrëveshje kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/c dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit...

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b)** Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.*

*Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit që provon kryerjen e shërbimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në Licensën e Shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për të paktën muajin e fundit të deklaruar:

1 (nje) Arkitekt ose Urbanist

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;

1 (nje) Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese, Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë. CV.

*\* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.*

*Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**Argumentimi:** Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “ Për prokurim publik” i ndryshuar dhe nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës e Projeçimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Arkitekt/Urbanist

Kerkohe per realizimin e shërbimeve të projektimit lidhura kryesisht me projektimin e godinës së shkolles dhe parkut të liqenit – i nevojshëm sipas kategorive të licencës, cituar në detyrë të projektimit, konkretisht për kategoritë 2 b), 2 c) dhe 2 d).

## Inxhinier Ndertimi

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin, si dhe konstruksionin ose /dhe kapacitetin mbajtes te godines se shkolles, per sinjalistiken rrugore, per ndertimin e veprave te artit tek kanali , zalli, sheshi ndermjet dy lagjeve etj. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 6 a), 11 a), 7 a) , 3 a), 12 a), 12 e) etj

## Inxhinier Hidroteknik;

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike per dimensionimin e tubacioneve te rrjetit te kanalizimeve te ujerave te bardha te sheshit si dhe llogaritjet sipas kushteve teknike te projektimit. Gjithashtu te percaktoje metodiken e realizimit veprave te artit qe lidhen me pjesen hidroteknike te kanalit vadites dhe zallit, si dhe per sistemin e furnizimit me uje te godines se shkolles

I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 5b), 5 c), 5 d) dhe 4 a).

## Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me azhornimin e objekteve dhe te gjithë hapesires ku mendohet te kaloje sistemi i KUB, te jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren per saktesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi, si dhe hartimin e planeve profileve terthore dhe gjatesore topografike me kuota relative dhe absolute, per sheshin , kanalin, perroin etj,

I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 8 a), 8 b),8 d) dhe 8 e)

2.3.3 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre stafin mbështetës dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për të paktën muajin e fundit :

1 (nje) Inxhinier Gjeolog ose Hidrogeolog

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1 (nje) Arkitekt ose Urbanist

1 (nje) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;

1 (nje) Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

1 ( nje) Inxhinier mjedisi ose 1 punonjes te pajisur me çertifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne pepruthje me klauzolat e ligjit nr.10440, date 07.07.20211 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis “te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome/certificate.

1 ( nje) ekspert zjarrëfikes (shoqeruar me certifikaten perkatese

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Çertifikate ose Diplomë. CV.

*\* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.*

*Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyren e Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Inxhinier Gjeolog ose Hidrogjeolog

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me studimet gjeologjike dhe hidrogjeologjike te trojeve dhe shpateve me qendrushmeri te ulet, hartimin e relacionit gjeologjik, përpara fillimit te projektit te zbatimit. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 9 a), 9 d) dhe 9 e), 12a) dhe 12 e).

Inxhinier Mekanik;

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin për realizmin e sistemit mekanik te godines se shkolles dhe atyre ne kanal in vadites. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 4 a), 4b) , 4f), 4j).

## Arkitekt/Urbanist

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin e godines se shkolles dhe parkut te liqenit – i nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 2 b), 2 c) dhe 2 d).

## Inxhinier Elektrik;

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin për realizmin e sistemit elektrik te godines se shkolles dhe ndricimit te sheshit. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 4 c), 11d).

## Inxhinier Hidroteknik;

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike per dimensionimin e tubacioneve te rrjetit te kanalizimeve te ujerave te bardha te sheshit si dhe llogaritjet sipas kushteve teknike te projektimit. Gjithashtu te percaktoje metodiken e realizimit veprave te artit qe lidhen me pjesen hidroteknike te kanalit vadites dhe zallit, si dhe per sistemin e furnizimit me uje te godines se shkolles

I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 5b), 5 c), 5 d) dhe 4 a).

## Inxhinier Gjeodet /topograf/markshajder

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me azhornimin e objekteve dhe te gjithë hapesires ku mendohet te kaloje sistemi i KUB, te jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren per sakesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi, si dhe hartimin e planeve profileve terthorë dhe gjatësore topografike me kuota relative dhe absolute, per sheshin , kanalin, perroin etj,

I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 8 a), 8 b),8 d) dhe 8 e)

1 ( nje) Inxhinier mjedisi ose 1 punonjes te pajisur me çertifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne pepruthje me klauzolat e ligjit nr.10440, date 07.07.20211 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis “te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome/certificate.

Është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve të Detyren e Projektimit.

1 ( nje) ekspert zjarrëfikes (shoqeruar me certifikaten perkatese)

Është i nevojshëm për hartimin e raportit dhe projektit të mbrotjes kundra zjarrit për godinen e shkolles, sipas pikes së licences për kategorinë 4 f).

#### 2.3.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Kat. 2 b) - Projektim: 1. Objekte sportive (fushat sportive tek Parku dhe terrenet e Shkolles)  
2. Objekte arsimore (shkolla e fshatit Zogje)  
3. Vepra arti në infrastrukture etj.

Kat. 2 c) - Projektim interiere.

Kat. 2 d) - Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe.

Kat. 3 a) – 2. Projektim objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

Kat. 4 a) – Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

Kat. 4 b) – Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

Kat. 4 c) – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale

Kat. 4 f) – Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

Kat. 4 i) – Projektim i ndriçimit rrugor, sheshe, dekorativ, ndriçimit të objekteve sportive etj.

Kat. 4 j) – Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

Kat. 5 b) – Projektim furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

Kat. 5 c) – Projektim ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.

Kat. 5 d) – Projektim vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino etj.

Kat. 6 a) – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Kat. 7 a) – Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Kat. 8 a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8 b) – Rilevime inxhinierike kadastrale

Kat. 8 d) – Bazamente gjeodezike.

Kat. 8 e) – Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Kat. 9 a) – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

Kat. 9 d) – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Kat. 9 e) – Studime e projektme hidrogjeologjike.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat. 11 d) – Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Kat. 12 a) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

Kat. 12 e) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi. (Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kat. 2 b) - Projektim: 1.Objekte sportive (fushat sportive tek Parku dhe terrenet e Shkolles)  
2. Objekte arsimore (shkolla e fshatit Zogje)  
3. Vepra arti ne infrastrukture etj.

Kat. 2 c) - Projektim interiere.

Kat. 2 d) - Projektim peizazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit për projektin e fushat sportive tek Parku dhe terrenet e Shkolles, sheshi në teresi dhe godinen e shkolles po ashtu.

Kat. 3 a) – Projektim objekte civile – industriale – turistike prejë murature e skelete beton-arme deri në 5 kate.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit për rikonstruksionin e godines së shkolles dhe studimin e konstruksionit të saj për ndonjë nderhyrje të mundshme. Gjithashtu edhe për veprat e artit tek objektet e tjera të projektimit.

Kat. 4 a) – Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

Kat. 4 b) – Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

Kat. 4 c) – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale

Kat. 4 f) – Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

Kat. 4 i) – Projektim i ndriçimit rrugor, sheshe, dekorativ, ndriçimit të objekteve sportive etj.

Kat. 4 j) – Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, sikunder është parashikuar që të realizohet edhe nderhyrjet tek shkolla për instalime hidraulike, elektrike, mekanike dhe MNZ, si dhe ndricimi i sheshit tek parku i liqenit

Kat. 5 b) – Projektim furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

Kat. 5 c) – Projektim ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.

Kat. 5 d) – Projektim vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino etj.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, në mënyrë që të realizohet projekti hidraulik tek godina e shkolle dhe sistemin e ujerave të bardha (KUB) për sheshin që do të projektohet, kanalin vadites si dhe mbrojtjen lumore tek zalli.

Kat. 6 a) – Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytesore dhe rrugë interurbane dytesore.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, ku tek sheshi kemi rrugica të ndryshme për sistemin e tij, kmbesore, bicikleta etj., të cilat mund të realizohen edhe me shtresa asfaltike.

Kat. 7 a) – Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, ku tek të gjitha objektet që do të projektohen përfshihen vepra arti të ndryshme të nevojshme për funksionalitetin e objektit.

Kat. 8 a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8 b) – Rilevime inxhinierike kadastrale

Kat. 8 d) – Bazamente gjeodezike.

Kat. 8 e) – Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet të kryhet azhurnimi i objekteve dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i kanalizimit të ujerave të bardha, të jepet plani i piktimit

dhe verifikimi paraprak ne terren per sakesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Parashikohet identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim, hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse, kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit, si dhe analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit, rrjedhimisht gjykohet e nevojshme kjo pike për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Kat. 9 a) – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

Kat. 9 d) – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Kat. 9 e) – Studime e projekte hidrogjeologjike.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet se projektuesi duhet të beje studimet e nevojshme gjeologjike te trojeve dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet, si dhe truallit ku ndodhet sheshi, godina e shkolle, zalli per mbrojtje lumore etj., për ndërtimin e objektit inxhinierik përpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat. 11 d) – Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, ku projekti kryesor lidhet me sheshin tek parku i liqenit, per te cilin parashikohet qe te kryhen rrugekalimet perkatese me sinjalistiken e nevojshme, te vendosen tabela rrugore dhe te behet ndricimi i sheshit.

Kat. 12 a) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

Kat. 12 e) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet se projektuesi duhet të beje studimet e nevojshme sizmike ne menyre qe te garantohet qendrueshmeria e shkolles dhe kryesisht tek punimet e sheshit te parkut te liqenit, i cili nga formacioni gjeologjik ka nevoje per studim te mirefillte, sipas shkalles se sizmicitetit per territorin ku do te shtrihet investimi, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

### **2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- a.** Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 /ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.5 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë,** pra të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë të realizimit të projekteve dhe me çmime të ulta, si dhe të sigurojë efektivitet dhe cilësi.

**ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale.** Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin.. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit në momentin që do të fillojë zbatimi i punimeve.

**ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia.** AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës që do të kryhet) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

### 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
  - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.
  - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.
- 1(një) Pajisje dron per fotogrametri dhe matjet
  - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

*\* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.*

*Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;*

*1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.*

## **1(një) Pajisje dron per fotogrametri dhe matjet**

*Kerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevimet qe lidhen me percaktimin e gjurmes dhe kuotave topografike per secilin objekt, vecanerisht per zonat ku ka dendesi bimore ose ndertesash dhe pajisja gjeodezike GPS nuk funksionon mire me valet ne keto zona , nevojitet pajisja Total Station Ose Pajisje droni*

*\* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.*

*Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

- Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

### **Shënim:**

Mospdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 09.01.2026, ora 10.<sup>00</sup>, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .**

### **NJËSIA E PROKURIMIT**